

AKTI I THEMELIT
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“RUIL EXCHANGE” SH.P.K.

TITULLI I

Dizpozita te përgjithshme

Neni 1

Sot, me date 20.01.2025 (dymije e njezetepese),ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar,respektivisht te ligjit numer 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” ,Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, krijohet shoqëria tregtare me emërtimin **“RUIL EXCHANGE”Sh.p.k** , e cila do te veproje në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe nenet e ketij akti.

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 2

Themeluesi i shoqerise **“RUIL EXCHANGE” Sh.p.k** eshte:

- **Z. ARB KINGJI**, atësia Gijafet, amësia Lumturi, shtetas Shqiptar, lindur në Vlore dhe banues në Vlore, me adresë Rruga “Rakip Malile; Nd. 24; H. 4; Ap. 5; Vlore 9401, lindur më 02/12/1983, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035691179 dhe nr. personal I31202059V

Neni 3

Forma ligjore e shoqerise do te jete “Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar”ose SHPK Megjithate, ajo mund te shnderrohet ne nje forme tjeter ne perputhje me legjislacionin tregetar shqiptar ne fuqi.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:
Veprimtaria financiare e kembimeve valutore.

Neni 5

Shoqeria e ka seline e saj ne:



Tirane ,Rruga Muhamet Gjollësia Tirane me nr, pasurie 6/487-N8 me zone kadastrale 8270 vol. 75, fq. 237..

Ajo mund të celë dhe adresa aktiviteti të tjera të dyta, dege e filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Neni 6

Shoqëria do të ketë kohezgjatjen e veprimtarisë së saj pa afat.

Neni 7

Shoqëria ka vullen e saj.

TITULLI II

Kapitali

Neni 8

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2.500.000 (dymilionepesëqindmijë) leke
Pjesëmarrja e ortakëve themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtem:

Aksionerët e shoqërisë zoterojnë dhe përqindje të kapitalit si më poshtë

1- Z. ARB KINGJI, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme nominale 2.500.000 leke që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

Neni 9

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimit të ortakëve.
Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asamblëja e ortakëve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e aktit.



Ne te gjitha rastet zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 10

Ortaku mund te transferoje te treteve kuotat e tij te kapitalit pjeserisht ose teresisht. Transferimi i kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete marre vendim asambleja e ortakeve me shumice absolute te votave.

Kuotat e kapitalit mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise.
- b) Shitblerjes.
- c) Trashegimise.
- d) Dhurimit.
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Organet vendimmarrese dhe drejtuese

Neni 11

Organet te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve.
- Administratori.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit te organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

TITULLI III

Asambleja e ortakeve

Neni 12

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor.

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarresi i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve merr vendime sa here e sheh te arsyeshme, por domosdoshmerisht per te miratuar pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.

Neni 13

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) Emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë;

- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shperndarjen e fitimeve dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 14

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike te ortakeve. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperm te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht kesaj parregullsie.

Neni 15

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 16

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat ($\frac{3}{4}$) e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per:

- a) Ndryshimin e statutit,
- b) Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,
- c) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore
- ç) Shperndarjen e fitimeve,
- d) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumice te votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- ç) Përcaktimin e shpërblimeve
- d) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- dh) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- e) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet në **QKB** për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

TITULLI IV

Administrimi

Neni 17

Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona si administrator të shoqërisë. Afati i emerimit është **5 vjet**, me të drejtë ripërteritjeje. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

Neni 18

Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretet për përmbushjen e aktivitetit të saj në përputhje me nenin 5 të këtij akti.

Organi Administrativ (administratori) ka të drejtë dhe duhet të:

- a) Kryejë me mirëbesim të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakëve e në interesin me të mirë të shoqërisë në teresi;
- b) Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) Përgatit dhe nënshkruaj pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) Kryej regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) Kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- f) Të punësojë, të pezullojë, të pushoj nga puna dhe të ndryshoj kushtet që lidhen me marrëdhënien e punës së personelit
- g) Përfaqësojë apo emërojë përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria ose në çështje të tjera me palë të treta;
- h) Të cele llogari rrjedhese bankare, të kryejë tërheqje depozitim dhe tërheqje parash, të jap dispozita të pageses, të verifikojë llogaritë rrjedhese dhe të miratojë llogarinë.

i) Te perfaqesoje shoqerine prane organeve publike,tatimore dhe administrative,edhe me qellim fitimin e koncesioneve,licencave dhe lejeve,duke emeruar,nese eshte e nevojshme mbrojtës te posacem.

j) Te nenshkruaj kontrat a shitblerje te mallrave dhe sherbimeve,ne kufijte e objektit te shoqerise.

Nese asambleja e pergjithshme emerom me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine, pervec rasteve kur ne vendimin e emerimit shprehet ndryshe.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

Neni 19

Administrator i shoqerise **“EXCHANGE KOMUNA” Sh.p.k**,emerohet:

- **Z. ARB KINGJI**, atësia Gijafet, amësia Lumturi, shtetas Shqiptar, lindur në Vlore dhe banues në Vlore, me adresë Rruga “Rakip Malile; Nd. 24; H. 4; Ap. 5; Vlore 9401, lindur më 02/12/1983, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035691179 dhe nr. personal I31202059V
- Afati i mandatit te administratorit do te jete **5 vjet** nga data e miratimit te ketij statuti.

Kushtet ekonomike

Neni 20

Shoqeria eshte pronare, disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi, mund te bleje, te shese, te jape ne perdorim, etj.

Neni 21

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve ne fuqi. Pasqyrat financiare periodike mujore, tremujore, gjashtemujore miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise.

Pasqyrat financiare vjetore nenshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e pergjithshme e Ortakeve.

Neni 22



Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 22

Marredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete akt do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykatën shqiptare.

Dispozita te vecanta

Prishja – Riorganizimi i Shoqerise

Neni 24

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe, per shkaqet:

- a) Me vendim te Asamblese se Ortakeve per prishjen e shoqerise;
- b) Sipas rasteve te parashikuara nga Ligji Tregtar;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) Me vendim te gjykates;

Neni 25

Ne rastin e prishjes se shoqerise, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likuidatore.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj punonjesve, shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet Ortakeve.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 26

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”.

Baza ligjore

Neni 27

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter ne Republiken e Shqiperise.

Neni 28

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteteve, zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates se Republikes se Shqiperise per zgjidhje.

Neni 29

Ky akt themelimi u perpilua ne prani te ortakut te shoqerise duke shprehur vullnetin e tij te plote e te lire.

Ai u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila, per t'u depozituar ne QKB, per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Adresa e emailit te shoqerise eshte arbkingji@gmail.com

Numri i telefonit do te jete +355693058353

Lexuar, miratuar dhe nenshkruar.

Tirane me 20.01.2025

ORTAKU THEMELUES TE SHOQERISE
"RUIL EXCHANGE" Sh.p.k

ARB KINGJI

Arb Kingji 